

---

**AKT THEMELIMI**  
**"KOAL 1" SHPK**

**1. Forma ligjore, emri i shoqërisë dhe ortaku themelues**

Emri i shoqërisë do të jetë **"KOAL 1" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm:

- **Z. Ardit Kastrati**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 24.03.1989, banues në Tiranë, Shqipëri, i identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. Personal identifikimi I90324080S.

**2. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Menaxhimi i pasurive të paluajtshme.**
- **Përfaqësimi dhe ndërmjetësimi i palëve të treta në kontrata të ndryshme tregtare.**
- **Shitja, blerja, marrja dhe dhënia me qera e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.**

Pa u kufizuar në sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

**3. Selia e shoqërisë**

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

- **Rruga "Dervish Hima" Ndërtesa nr. 2, Hyrja nr. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tiranë, Shqipëri.**

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**4. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

---

## 5. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 500,000 (pesëqind mijë lekë)**.

Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **ALL 500,000 (pesëqind mijë lekë)** dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

## 6. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## 7. Administratori

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është:

- **Zj. Anila Kastrati**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 04.09.1992, lindur ne Fier dhe banuese në Tiranë, e identifikuar nga Letërnjoftimi me numër personal Identifikimi J25904058G.

## 8. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

### ORTAKU I VETËM

**Z. Ardit Kastrati**

Ardit Kastrati 

[emër mbiemër dhe nënshkrimi]

**Datë 12.06.2024.**